



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 01/191
Datë: 05.03.2024

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4, dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 5 mars 2024, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet Ekstrakti i Procesverbalit dhe Transkriptit nga mbledhja e 186 e Qeverisë së Republikës së Kosovës.
2. Aprovohen ekstraktet e procesverbaleve nga mbledhjet: 185 dhe 187 elektronike/korresponduese të Qeverisë së Republikës së Kosovës.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrave (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 02/191

Datë: 05.03.2024

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 5 mars 2024, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet Rregullorja për Organizimin dhe Fushëveprimin e Shtëpive për Mbrojtjen e Fëmijës.
2. Obligohet Ministria e Drejtësisë dhe institucionet tjera kompetente për zbatimin e Rregullores nga pika 1. e këtij Vendimi.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrave (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 03/191
Datë: 05.03.2024

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 5 mars 2024, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet propozimi i Ministrisë së Mbrojtjes për dhënien në shfrytëzim të pronave të Republikës së Kosovës për nevoja të Ministrisë së Mbrojtjes dhe Forcës së Sigurisë së Kosovës, dhe atë: Njësia Kadastrale: P-71712032-00900-0, Zona Kadastrale Dumosh – Podujevë, Njësia Kadastrale: P-71712067-00120-0, Zona Kadastrale Radujevë – Podujevë, Njësia Kadastrale P-71712036-00082-0, Zona Kadastrale Kaçybeg – Podujevë (Aeroporti i Dumoshit) dhe Njësia Kadastrale: P-71914045-00273-0, Zona Kadastrale Llukar – Prishtinë (ish kazerma Llukar).
2. Obligohet Ministria e Mbrojtjes dhe institucionet e tjera kompetente për zbatimin e këtij Vendimi.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e shpalljes së tij në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrave (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 04/191
Datë: 05.03.2024

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, nenit 25 paragrafit 1. të Ligjit Nr. 08/L-260 mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2024, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 5 mars 2024, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet kërkesa e Ministrisë së Ekonomisë për ndarje të mjeteve buxhetore në shumë prej 50,000€ (pesëdhjetë mijë euro) për financimin e projektit "Trajtimi i Ujërave të Zeza në Ferizaj", nga fondet e huamarrjes.
2. Mjetet buxhetore sipas pikës 1. të këtij Vendimi merren nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve me kod 201, nga nën-programi "Huamarrja për projekte potenciale brenda MFPT" me kod 48900, nga kategoria e shpenzimeve "Subvencione dhe Transfere" dhe ndahen në Ministrinë e Ekonomisë, me kod 213, në nën-programin "Uji dhe Hedhurinat" me kod 22500, në kategorinë e shpenzimeve "Mallra dhe Shërbime", burimi i financimit Financimi nga Huamarrja (04).
3. Obligohet Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve dhe Ministria e Ekonomisë për zbatimin e këtij Vendimi.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrave (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 05/191
Datë: 05.03.2024

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, nenit 4 të Ligjit Nr. 04/L-052 për Marrëveshjet Ndërkombëtare, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 5 mars 2024, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet në parim Nisma për lidhjen e Marrëveshjes për amendamentimin e Marrëveshjes për themelimin e Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim, e ratifikuar në Kuvendin e Republikës së Kosovës me Ligjin Nr. 04/L-169 për Ratifikimin e "Marrëveshjes për themelimin e Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim" dhe e shpallur me Dekretin Nr. DL-055-2012 të datës 13 dhjetor 2012 nga Presidentja e Republikës së Kosovës.
2. Obligohet Ministria e Financave Punës dhe Transfereve për ndërmarrjen e hapave konform dispozitave të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, Ligjit Nr. 04/L-052 për Marrëveshjet Ndërkombëtare dhe legjislacionit tjetër në fuqi.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 06/191
Datë: 05.03.2024

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, nenit 4 të Ligjit Nr. 04/L-052 për Marrëveshjet Ndërkombëtare, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 5 mars 2024, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet në parim Nisma për lidhjen e Marrëveshjes për Bashkëpunim Gjyqësor në Çështje Penale ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Qeverisë së Republikës të Austrisë.
2. Obligohet Ministria e Drejtësisë për ndërmarrjen e hapave konform dispozitave të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, Ligjit Nr. 04/L-052 për Marrëveshjet Ndërkombëtare dhe legjislacionit tjetër në fuqi.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrave (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 07/191
Datë: 05.03.2024

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 5 mars 2024, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet Strategjia dhe Plani i Veprimit për Armët e Vogla, të Lehta dhe Eksplozivëve 2024-2028.
2. Koordinator Nacional për Planin e Veprimit për AVLE, caktohet Ministri i Punëve të Brendshme, i cili këtë përgjegjësi mund ta delegojë te njëri nga zëvendësministrat e Ministrisë së Punëve të Brendshme.
3. Obligohet Ministria e Punëve të Brendshme dhe institucionet tjera kompetente për zbatimin e Strategjisë dhe Planit të Veprimit për Armët e Vogla, të Lehta dhe Eksplozivëve 2024-2028 nga pika 1. e këtij Vendimi.
4. Vendimi hyn në fuqi në ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrave (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 08/191

Datë: 05.03.2024

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 5 mars 2024, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet Raporti Vjetor 2023 për Implementimin e Programit për Eliminimin e Barrierave në Tregti sipas neneve 34 - 36 TFBK (2021 - 2025).
2. Obligohet Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë për zbatimin e këtij Vendimi.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrave (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 09/191
Datë: 05.03.2024

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4, dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, nenit 8 të Ligjit Nr. 03/L-060 mbi për Kualifikimet Kombëtare, të neneve 12 dhe 38 të Ligjit Nr. 08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 5 mars 2024, merr këtë:

V E N D I M

1. Ndryshohet dhe plotësohet Vendimi i Qeverisë së Kosovës Nr. 05/121 i datës 25 janar 2023 për emërimin e anëtarëve të Këshillit drejtues të Autoritetit të Kualifikimeve si në vijim: nën-nënpika 1.4.1. znj. Albana Sahiti-Morina, zëvendësohet me z. Niman Bardhi.
2. Pika 3. e Vendimit Nr. 05/121 i datës 25 janar 2023, zëvendësohet me këtë tekst:
 - 2.1. Anëtarët e Këshillit drejtues të Autoritetit Kombëtar të Kualifikimeve do të kompensohen me pagesë për punën e kryer, në përputhje me legjislacionin në fuqi.
3. Pika 3. e Vendimit Nr. 05/121 i datës 25 janar 2023, zëvendësohet me 4.
4. Obligohet Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit dhe Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve për zbatimin e këtij Vendimi.
5. Ky Vendim është pjesë përbërëse e Vendimit të Qeverisë Nr. 05/121 të datës 25 janar 2023.
6. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrave (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 10/191
Datë: 05.03.2024


Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, nenit 11, paragrafit 12. të Ligjit Nr.08/L-260 mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2024, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 5 mars 2024, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet kërkesa e Zyrës së Kryeministrit, Ministrisë së Drejtësisë dhe Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit për ndarje të mjeteve buxhetore në shumë prej 900,000 €, (nëntëqind mijë euro), për realizimin e projekteve përmes marrëveshjeve me trupat e Organizatës së Kombeve të Bashkuara.
2. Mjetet buxhetore sipas pikës 1. të këtij Vendimi merren nga Ministria e Financave Punës dhe Transfereve me kod 201, nga nën-programi "Marrëveshjet me trupat e Organizatës së Kombeve të Bashkuara" me kod 34100, nga kategoria e shpenzimeve "Subvencione dhe Transfere", dhe ndahen si vijon:
 - 2.1. Në Ministrinë e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, me kod 207, ndahet shuma prej 300,000 € (treqind mijë euro), në nën-programin "Mbrotjtja Ruajtja e Trashëgimisë Kulturore" me kod 81500, në kategorinë e shpenzimeve "Subvencione dhe Transfere";
 - 2.2. Në Zyrën e Kryeministrit me kod 104, ndahet shuma prej 300,000 € (treqind mijë euro), në nën-programin "Shërbimet e Statistikës" me kod 12400, në kategorinë e shpenzimeve "Subvencione dhe Transfere";
 - 2.3. Në Ministrinë e Drejtësisë me kod 215, ndahet shuma prej 300,000 € (treqind mijë euro), në nën-programin "Departamenti për Integritet Evropian dhe KE " me kod 27000, në kategorinë e shpenzimeve "Subvencione dhe Transfere".
3. Obligohet Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve, Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, Zyra e Kryeministrit dhe Ministria e Drejtësisë për zbatimin e këtij Vendimi.

4. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI



Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 11/191
Datë: 05.03.2024

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, nenit 19 të Ligjit Nr. 03/L-95 për të Drejtat e ish të Dënuarve dhe të Përndjekurve Politikë, si dhe në përputhje me nenin 4 të Rregullores Nr. 26/2012 të Punës së Komisionit Qeveritar për të Drejtat e ish të Burgosurve, të ish të Dënuarve e të ish të Përndjekurve Politikë, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 5 mars 2024, merr këtë:

V E N D I M

Për ndryshimin dhe plotësimin e Vendimit të Qeverisë Nr. 09/24 të datës 11 gusht 2021, i ndryshuar dhe plotësuar me Vendimin Nr. 18/47, të datës 10 dhjetor 2021, si dhe me Vendimin Nr. 06/73 të datës 30 prill 2022


1. I Vazhdohet mandati Komisionit Qeveritar për Njohjen e Statusit të ish të Dënuarve dhe ish të Përndjekurve Politik në afat kohorë dy (2) vjeçar, në këtë përbërje:
 - 1.1. Fadil Bunjaku, përfaqësues nga Ministria e Drejtësisë;
 - 1.2. Bora Duli, përfaqësuese nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve;
 - 1.3. Jahë Gecaj, përfaqësues nga Ministria e Shëndetësisë;
 - 1.4. Hydajet Hyseni – Kaloshi, përfaqësues nga Kuvendi i Kosovës;
 - 1.5. Berat Luzha, përfaqësues nga Shoqata e ish të Burgosurve Politik të Kosovës;
 - 1.6. Mazllum Baraliu, përfaqësues nga Shoqata e Juristëve të Kosovës.
2. Obligohet Komisioni nga pika 1. e këtij Vendimi që të veprojë në përputhje me Ligjin Nr. 03/L-95 për të Drejtat e ish të Dënuarve dhe të Përndjekurve Politik, me Rregulloren Nr. 26/2012 të Punës së Komisionit Qeveritar për të Drejtat e Ish të burgosurve, të Ish të Dënuarve e të Ish të Përndjekurve Politik si dhe me dispozitat tjera ligjore në fuqi.
3. Anëtarët e Komisionit Qeveritar për Njohjen e Statusit të ish të Dënuarve dhe ish të Përndjekurve Politik për punën dhe angazhimin e tyre kompensohen nga programi 11315 Administrata Qendrore MD, kategoria ekonomike e mallrave dhe shërbimeve.
4. Obligohet Ministria e Drejtësisë për zbatimin e këtij Vendimi.

5. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

A r s y e t i m

Me qëllim të realizimit të autorizimeve, detyrave dhe objektivave që derivojnë nga legjislacioni përkatës në fuqi, u vendos si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Albin KURTI



Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 12/191
Datë: 05.03.2024

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, në përputhje me nenin 15 të Rregullores Nr. 26/2012 të Punës së Komisionit Qeveritar për të Drejtat e ish të Burgosurve, të ish të Dënuarve e të ish të Përndjekurve Politikë, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 5 mars 2024, merr këtë:

V E N D I M


Për ndryshimin dhe plotësimin e Vendimit të Qeverisë Nr. 18/47 të datës 10 dhjetor 2021

1. I Vazhdohet mandati Sekretarisë së Komisionit Qeveritar për Njohjen e Statusit të ish të Dënuarve dhe ish të Përndjekurve Politik në afat kohorë prej dy (2) vjeçar, në këtë përbërje:
 - 1.1. Shefik Sadiku, udhëheqës i Sekretarisë;
 - 1.2. Naime Sherifi, zyrtarë;
 - 1.3. Faik Ajeti, zyrtar.
2. Ndryshohen dhe plotësohen pikat 5a dhe 6a të Vendimit të Qeverisë Nr.18/47 të datës 10 dhjetor 2021 si në vijim:
 - 5a. Udhëheqësi i Sekretarisë për punën dhe angazhimin e tij paguhet me pagë mujore bruto në vlerë prej 650.00 €.
 - 6b. Anëtarët e Sekretarisë për punën dhe angazhimin e tyre paguhet me pagë mujore bruto në vlerë prej 600.00 €.
3. Ndërsa, pika 7a e Vendimit të Qeverisë Nr.18/47 të datës 10 dhjetor 2021 fshihet.
4. Anëtarët e Sekretarisë së Komisionit Qeveritar për punën dhe angazhimin e tyre kompensohen nga programi 11315 Administrata Qendrore MD, kategoria ekonomike e mallrave dhe shërbimeve.
5. Obligohet Ministria e Drejtësisë për zbatimin e këtij Vendimi.
6. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

A r s y e t i m

Me qëllim të realizimit të autorizimeve, detyrave dhe objektivave që derivojnë nga legjislacioni përkatës në fuqi, ofrimit të mbështetjes teknike dhe administrative për Komisionin dhe mbarëvajtjes së punës në Komision si dhe duke pas parasysh legjislacionin përkatës në fuqi për punën e Komisionit dhe Sekretarisë, u vendos si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Albin KURTI



Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 13/191
Datë: 05.03.2024

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, nenit 5 paragrafi 1. të Ligjit Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, Ligjit Nr. 04/L-111 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 5 mars 2024, merr këtë:

V E N D I M

1. Shkarkohet Bordi i Drejtorëve të Ndërmarrjes Publike Qendrore, Kompania Rajonale e Ujësjiellit "Hidroregjioni Jugor" Sh. A. Prizren.
2. Ky Vendim shfuqizon Vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 04/92 të datës 10 gusht 2022.
3. Emërohet Bordi i Përkohshëm i NP KRU "Hidroregjioni Jugor" Sh. A. Prizren, në këtë përbërje:
 - 3.1. Z. Ismet Vrapçani, kryesues;
 - 3.2. Znj. Dhurata Gutaj, anëtare;
 - 3.3. Z. Taulant Tanushaj, anëtar;
 - 3.4. Znj. Sibel Halko Shatri, anëtare.

A r s y e t i m

Arsyet e shkarkimit të Bordit të Drejtorëve të N. P. KRU "Hidroregjioni" Sh. A. Prizren, i emëruar me Vendimin e Qeverisë Nr.04/92 të datës 10 gusht 2022, janë të sqaruara në Memorandumin Shpjegues të Ministrisë së Ekonomisë, të datës 23 shkurt 2024.

4. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrave (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Ekonomisë
Ministarstvo Ekonomije /Ministry of Economy

MEMORANDUM SHPJEGUES

**Për Propozim-Vendimin për shkarkimin e Bordit të Drejtorëve të Ndërmarrjes Publike
Kompania Rajonale e Ujësjellësit "Hidroregjioni jugor" ShA**

Prishtinë, 23.02.2024

Kompania Rajonale e ujësjellësit Hidroregjioni"Sh.A Prizren është ndërmarrje publike qendrore, në pronësi të plotë të Republikës së Kosovës.

Bordi i Drejtorëve i Ndërmarrjes është emëruar me Vendimin nr.04/92 të Qeverisë të 10 gusht 2022. Njësia për Politika dhe Monitorimin e Ndërmarrjeve Publike (NJPMNP), që vepron në kuadër të Ministrisë së Ekonomisë, ka monitoruar punën e Bordit të Drejtorëve i cili nënkupton personin që drejton takimet e Bordit të Drejtorëve të kësaj Ndërmarrjeje, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Aksionari në mandatin saj të dhënë me legjislacionin në fuqi për ndërmarrje publike për NP-të, mbështetur në Nenin 7.1 Aksionari(ët) e një NP do të ushtrojë mbikëqyrje të vazhdueshme dhe rigoroze të veprimtarisë së Bordit të Drejtorëve dhe Komisioneve të Auditimit të NP-së në fjalë.

Njësia për Politika dhe Monitorimin e Ndërmarrjeve Publike (NJPMNP), Në kuadër të kompetencave të veta, ka analizuar planet e biznesit dhe raportet periodike të Ndërmarrjes. Bazuar në raportin vjetor për vitin 2022 dhe në draft-raportin vjetor për vitin 2023, vërehet se Ndërmarrja ke devijuar nga caqe e përcaktuara nga bordi i drejtorëve në planin e biznesit. Devijimet më të rënda janë te faturimi i ujit në metër kub, faturimi nga uji në euro, si dhe te uji i pa faturuar në metër kub të cilat NJPMNP i ka prezantuar në rekomandimin e adresuar ministres së ekonomisë me datën 23.02.2024, dhe mos informim dhe komunikim i rregullt me aksionarin.

Në përgjithësi, NJPMNP konsideron se bordi i drejtorëve është dashur të sigurojë planifikim efektiv dhe mbikëqyrje rigoroze në zbatimin e planit. Nuk ka rrethana ose ngjarje negative të paparashikueshme.

Sa i përket sasisë së ujit të pa faturuar (humbjes së ujit), vërehet se për vitin 2022 ka pasur të dhëna bazë të gabuara dhe raportim të pasaktë, duke pasur parasysh auditimin nga Autoriteti Rregullator për Shërbimet e Ujit dhe duke pasur parasysh se sasia e ujit të pa faturuar në plan dhe raportin për vitin 2023 është dukshëm më e lartë. Edhe pse performanca e Ndërmarrjes është raportuar si pozitive sa i përket zvogëlimit të humbjes në vitin 2022, raportimi është i pasaktë dhe realizimi për vitin 2023 është negativ.

Për sa u tha më sipër, Ndërmarrja ka devijuar rëndë për dy vjet radhazi prej cazeve të përcaktuara nga bordi i drejtorëve në planin e biznesit. Për këto arsye, duke u bazuar në nenin 7.3 dhe 7.5 të Ligjit për Ndërmarrjet Publike i plotësuar dhe ndryshuar, NjPMNP i rekomandon aksionarit të shkarkojë dhe të zëvendësojë anëtarët e bordit të drejtorëve.

Sipas nenit 15.2 të Kodit të Etikës dhe Qeverisjes Korporative për Ndërmarrjet Publike, Bordi duke pas përgjegjësi të identifikoj biznesin dhe konkurrencën e tij, ka obligim të themeloj standarde të larta të performancës operative dhe financiare, duke qenë përgjegjës për drejtimin e planeve të Ndërmarrjes.

Nga ky obligim ligjor, Bordi aktual nuk ka siguruar aksionarin në përmbushjen e obligimit mbështetur në kompetencat që u ka dhënë legjislacioni në fuqi për ndërmarrjet publike.

Rrjedhimisht, mbështetur në nenet 19 dhe 43 të Ligjit për Ndërmarrjet Publike, Ministria e Ekonomisë propozon që Qeveria të shkarkojë bordin e drejtorëve të Ndërmarrjes dhe të emërojë një bord të përkohshëm. Bordi i përkohshëm shërben deri në emërimin e bordit me mandat të rregullt, por jo më gjatë se gjashtë muaj.